



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 120, datë 27.04 .2021

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, gërma a të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. **Z. Erion Çela**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Gjykatës së Apelit Vlorë, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
2. Z. Erion Çela, do të ushtrojë funksionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, nga data 27.04.2021 - 26.07.2021.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, Çela do të paguhet me pagën e pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
4. Të njoftohen për këtë vendim Z. Erion Çela, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

GENT I BRAHIMI

ZV/KRYETAR

ALFRED BALLA

ANËTAR

KOSTAQ BELURI

ANËTAR

BUJAR SHESHI

ANËTAR


NURIHAN SEITI

ANËTAR

SANDËR BECI



ANËTAR
ELOIDA GOXHI



ANËTAR

VATË STAKA



ANËTAR
ESMERALDA KESHI



ANËTAR

TARTAR BAZAJ

ANËTAR
MOISI DUDA

